



### **Ismail Januzi – Drejtor**

Ismail Januzi ka lindur në Gjilan në vitin 1961. Edukimin universitar e ka përfunduar në Prishtinë, në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Teknik. Është inxhinier i diplomuar i Makinerisë.

Gjatë viteve 2014-2015, z. Januzi u emërua drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, në Komunën e Gjilanit, ku ka qenë i angazhuar në zhvillimin e programeve lokale për zhvillim ekonomik. Para emërimit si drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, z. Januzi ka shërbyer si drejtor në Bordin e Drejtorëve në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) për një periudhë tri vjeqare. Gjate periudhës si drejtor në bordin e drejtoreshave të KEK, ai gjithashtu ka qenë i angazhuar edhe në komisionin e auditimit të korporatës.

Z. Januzi, përveq eksperiencës së tij në sektorin publik, ka qenë dhe vazhdon të jetë i angazhuar edhe në sektorin privat. Gjatë viteve 2005-2012, ai ka shërbyer si kryetar i Komunitetit të Biznesit “Reforma” në Gjilan, ku nëpërmjet programeve të ndryshme kontriboi në fuqizimin e sektorit privat si dhe zhvillimin e inkubatorit të biznesit në Gjilan.

Ndër të tjera, Z. Januzi ka kontribuar edhe në fuqizimin e Klubit të basketbollit dhe futbollit “Drita” në Gjilan, për gati dhjetë vite. Ai ka qenë dhe vazhdon të jetë aktivist i shumë kauzave bamirëse duke ndihmuar në hapjen e qendrave bamirëse, ndërtimin e shkollave, si dhe zhvillimin e arsimit e kulturës në Gjilan.